

VENDIM
Nr. 126, datë 31.5.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “b” dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1 germa “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 830/3 prot., datë 27.5.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Energy Financing Team Tirana’ sh.p.k., me nr. 390, seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 26.10.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 66, datë 11.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/8 prot., datë 13.4.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.4.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gerrat “b”, “c”, “d”;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, gerrat “a”, “c”, “d”, “f”, “h”.

Në lidhje me mungesën e konstatuar në dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Vlerësohet t’i lihet shoqërisë kusht në vendim që të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.7

- germa “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.) Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, vlerësohet t’i lihet shoqërisë kusht në vendim të që të përcjellë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e vendimit, dokumentet që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve.

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 390, seria F17, në veprimtarinë së furnizimit të energjisë elektrike që nga data 26.10.2017, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119 me afat vlefshmërie deri në datën 26.10.2022.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Sikurse konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 10.2.2022, gati 8 (tetë muaj) përpara përfundimit të afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të rregullores ndaj si e tillë vlerësohet që në dispozitiv të specifikohet data e fillimit të vlefshmërisë së licencës duke filluar nga data 27.10.2022.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike bazuar në aneksin A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 390, seria F17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 174, data 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2022.

2. Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.

3. Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e vendimit, dokumenta që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti